

Friendly wi-Fi Albania është:



një alternativë e lehtë për tu përdorur që filtron materialet e papërshtatshme;



një simbol i njohur ndërkombëtarisht çertifikimi;



është i sigurt, i besueshëm dhe i shpejtë;



i mbron fëmijët nga pornografia.

“Friendly Wi-Fi Albania” është një nismë e zyrës së UNICEF Shqipëri në bashkëpunim me Bashkitë më të mëdhaja të vendit.

Gjeni vendet ku ka “Friendly Wi-Fi” në adresën:

www.friendlywifi.al



UNICEF Shqipëri shpreh mirënjohjen për mbështetjen financiare të programit “Ti japim Fund Dhunës Kundër Fëmijëve”



SI TË MBAJME
FËMIJËT TË
SIGURT ONLINE

#FriendlyWiFiAlbania
#jamisigurtonline

Interneti është:



një botë plot me mundësi;



zhvillim i teknologjisë;



pajisje inovatore
(smartphone, kompjuter, tablet, etj);



hapësira qytetase ku gjen wireless;



argëtim
(YouTube, media sociale, etj).

Interneti është edhe:



cyberbullying
(ngacmimet, kërcënimet apo poshtërimet
në internet);



takimi me njerëz të panjohur;



përballja me materiale pornografike dhe të
papërshtatshme për fëmijët;



publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave
personale nga "miqtë" apo të panjohurit;



lojëra me përmbajtje të dhunshme që nxisin
sjellje agresive.

A e di ti se:

- çdo gjë që shkruan dhe poston online, mbetet aty përgjithmonë, veçanërisht fotografitë dhe videot vetjake?
- cyberbullying është një prej rreziqeve që fëmijët dhe të rinjtë ndeshin në internet?
- interneti ka edhe përmbajtje të dëmshme dhe të paligjshme si dhuna, pornografia e fëmijëve, etj.?
- hapja e materialeve bashkëlidhur ('attachments') ose linqet e faqeve të internetit, mund të të rrezikojë ty dhe të të dëmtojnë kompjuterin/tabletin/smartphonin tënd?
- të postosh në internet të dhënat vetjake vë në rrezik privatësinë tënde (si psh. fotografi, numrin e telefonit celular, adresën e shtëpisë, etj.)?
- rrezikohesh më shumë nga hakërimi nëse hyn online në wi-fi publik?

Zgjidh të jesh i sigurt online!
Zgjidh "Friendly Wi-Fi Albania".